



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

MINISTRI

5939  
Nr.....Prot.

Tiranë më 08/08/2014

**UDHËZIM**

Nr. 22, datë 08.08.2014

**PËR  
STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2014-2015 NË INSTITUCIONET PUBLIKE DHE PRIVATE  
TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Viti akademik 2014-2015 në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, të fillojë në datën 20 Tetor 2014 dhe të përfundojë në datën 30 Shtator 2015.
2. Periudha 22 Dhjetor 2014 deri në 4 Janar 2015, të jetë periudhë pushimesh për studentët.
3. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjitha ndërmarrjet "Trajtimi i Studentëve", listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve, ndërmarrjet "Trajtimi i Studentëve" sh.a dhe institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

